

Çfarë ndodh me kërkesën tuaj kur ta filloni procedurën?

Veprimi i parë, pas dorëzimit të kërkesës, është regjistrimi i kërkesës suaj dhe lëshimi i letrës së konfirmimit nga institucionet.

Këshillë: Gjithmonë kërkonte letrën e konfirmimit nëse ajo nuk u ofrohet nga institucioni. Ky dokument është dëshmi se ju keni dorëzuar kërkesën në datën e cekur, që është element i rëndësishëm për përcaktimin e afatit për përgjigje.

INSTITUCIONI DUHET T'JU INFORMOJË LIDHUR ME VENDIMIN E TIJ MBI KËRKESËN TUAJ BRENDË 7 DITËVE PUNE NGA DATA E REGJISTRIMIT TË KËRKESËS SUAJ

Në rast se kërkesa juaj është e paqartë apo nëse është adresuar tek institucioni që nuk e posedon atë dokument, është obligim ligjor i zyrtarit komunal që ka pranuar kërkesën tuaj t'ju japë udhëzime për plotësimin e saktë të kërkesës dhe/apo t'ju referojë tek adresa e duhur nëse kërkesa juaj për qasje në dokument publik është adresuar në institucionin e gabuar.

Brenda 7 ditëve të punës, institucioni duhet t'ju informojë lidhur me vendimin e tyre, me shkrim, lidhur me:

- Lejimin e qasjes në dokumente publike;
- Refuzimin e qasjes në dokumente publike;
- Refuzimin e pjesshëm të qasjes në dokumente publike.

Komuna mund ta lejojë qasjen në dokumentin publik që e kërkonte edhe duke ju referuar në burimet e duhura që janë lehtësisht të qasshme në faqet zyrtare të internetit të institucionit përkatës. Për shembull, nëse e kërkonte Ligjin për vetëqeverisje lokale, zyrtari mund t'ju referojë tek faqja e internetit të Kuvendit të Kosovës apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, pa ju siguruar një kopje të ligjit.

Ku të ankoheni nëse kërkesa juaj për qasje në dokumente publike është refuzuar?

Ekzistojnë dy mekanizma të ankimimit të parapara me ligj për ta sfiduar vendimin e institucionit që nuk ju ka lejuar qasjen në dokumentin publik:

- Të kërkonte nga institucioni që ta rishikojë vendimin e tij;
- Të paraqitni një ankesë pranë Avokatit të Popullit, institucioneve të tjera publike, apo në gjykatë.

Mund t'i shfrytëzoni këto mekanizma të ankimimit brenda 15 ditëve nga data kur e keni pranuar vendimin për refuzim të plotë apo të pjesshëm në dokumentin publik apo duke filluar nga data e përfundimit të afatit shtatëditor për dhënie të përgjigjes.

MUNGESA E PËRGJIGJES NGA INSTITUCIONI NË KËRKESËN TUAJ BRENDË AFATIT LIGJOR KONSIDEROHET SI PËRGJIGJE NEGATIVE



E DREJTA PËR TU INFORMUAR PËR PUNËN E KOMUNËS SUAJ

Si t'i qaseni dokumenteve publike në komunën tuaj

Cila është baza ligjore për të kërkuar qasje në dokumente publike?

Është e drejtë e çdo personi fizik apo juridik që të informohet për aktivitetet e institucioneve publike, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 03/L-215 për qasje në dokumente publike.

E DREJTA PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE ËSHTË E GARANTUAR ME LIGJ

Kushtetuta dhe ligji garantojnë të drejtën tuaj për qasje në dokumente publike të cilat mbahen, hartohen apo pranohen nga të gjitha institucionet publike lokale dhe qendrore. Ju keni të drejtë në qasje në dokumentet publike në cilëndo nga gjuhët zyrtare të Kosovës, pa diskriminim në çfarëdo baze.

SIPAS RREGULLIT, JU KENI TË DREJTË TË QASJES NË TË GJITHA DOKUMENTET PUBLIKE, ME PËRJASHTIME TË PËRCAKTUARA ME LIGJ

Përfshirjet për të cilat mund të refuzohet qasja në dokumentet publike:

- Siguria;
- Siguria publike;
- Parandalimi i veprimtarisë kriminale;
- Hetimet disiplinore;
- Inspektimi nga institucionet publike;
- Privatësia;
- Interesat komerciale dhe ekonomike;
- Politikat monetare;
- Administrimi efikas i drejtësisë;
- Mjedisi;
- Diskutimet brenda institucioneve publike.

Nëse përcaktohen arsyetimet e tilla, qasja mund të refuzohet në tërë dokumentin apo në disa pjesë të tij.

NËSE ËSHTË KUFIZUAR E DREJTA JUAJ PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE, INSTITUCIONI KA OBLIGIM LIGJOR TË JU LËSHOJË ARSYETIM ME SHKRIM PËR VENDIMIN E TYRE

E ashtuquajtura barrë e provës në procesin e qasjes në dokumente publike qëndron mbi mbajtësit e dokumenteve, përkatësisht tek institucioni dhe jo tek kërkuesi i dokumentit publik. Për më tepër, kërkuesi nuk është i detyruar të paraqes asnjë justifikim për institucionin lidhur me arsyet e kërkesës për qasje në dokumente publike.

Çfarë është një dokument publik?

Dokument publik mund të jetë çdo letër zyrtare që shërben për të dëshmuar apo përcaktuar diçka, pavarësisht nga forma apo karakteristikat e saj fizike. Një dokument publik përfshin informatën e regjistruar në çdo formë, të hartuar dhe të pranuar nga komuna, duke përfshirë tekstet e shkruara apo shtypura, hartat, oraret, fotografitë, vizatimet, skicat, materialet punuese të ruajtura në formë magnetike apo elektronike. Disa shembuj të dokumenteve publike komunale janë:

- Vendimi nga administrata për çështje pronësore;
- Raportet vjetore narrative nga departamentet;
- Buxheti i komunës;
- Procesverbalet nga takimet e kuvendit komunal;
- Vendimi i kuvendit komunal; Vendimi nga Kryetari i Komunës;
- Projektet e komunës.

LEXIMI I DOKUMENTIT NË LOKACION ËSHTË PA PAGESË, NDËRSA SIGURIMI I KOPJES FIZIKE MUND TË JETË ME PAGESË

Pagesa për qasje në dokumente publike është e paraparë me rregulloren 02/2012 për tarifat në qasje në dokumente publike:
<https://mf.rks-gov.net/sq-al>

Si mund ta kërkonte qasjen në dokumente publike?

Përmes dorëzimit të kërkesës në institucionin që mendoni se e ka në posedim dokumentin e kërkuar.

Kërkesa duhet t'i përfshijë informatat vijuese:

- Institucioni të cilit ia adresoni kërkesën;
- Titullin e dokumenteve që i kërkonte;
- Emrin dhe informatat kontaktuese.

Këshillë: Kur të shkoni në komunën tuaj për ta dorëzuar kërkesën tuaj, kërkonte zyrtarin komunal përgjegjës për qasje në dokumente publike i cili do ta pranojë kërkesën tuaj

NUK JENI TË OBLIGUAR QË KËRKESËN PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE TA DORËZONI NË NJË FORMË TË CAKTUAR

Kërkesa juaj për qasje në dokumente publike nuk mund të refuzohet për shkak të formatit. Formularët e përgatitur nga institucionet janë vetëm për t'ua lehtësuar procedurën; por, nuk jeni të obliguar që t'i përdorni ato.